



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVO		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Dërguar më	17-06-2026	
Dostavljeno		
Njësi.org.	Nr.	Shtojcë -
Org. led.	Br.	Prilog
01-060/23-0035268/26		
PODUJEVË - PODUJEVO		



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYESUESI I KUVENDIT

NJOFTIM / FTESE

për vazhdimin e seancës së Kuvendit të Komunës të datës 28 maj 2026.

Të nderuar/a

Siç e dini, në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të datës 28 maj 2026, ndër çështjet tjera ka qenë në diskutim edhe pika e rendit të ditës (pika 7) **Informatë e Drejtorisë së Arsimit rreth ndarjes së Bursave për studentë për vitin akademik 2025/2026**, e cila ka hyrë si pikë shtesë në fillim të asaj mbledhje.

Sa për rikujtim, për këtë pikë të rendit të ditës është zhvilluar diskutim / debat në Kuvend nga një pjesë e anëtarëve/eve të Kuvendit sa ishin prezent, mirëpo në përfundim e sipër të debatit, pati një kërkesë që kjo mbledhje të ndërpritet për arsye të debateve personale, dhe jashtë rendit të ditës, dhe njëkohësisht për shkak se seanca nuk kishte kuorum të mjaftueshëm të vazhdonte tutje.

Si Kryesues i Kuvendit kam vlerësuar se kjo pikë e rendit të ditës, konkretisht debati për këtë ishte në përfundim e sipër, si dhe duke marrë për bazë kërkesën për ndërprerjen e seancës për shkak se në ato rrethana nuk mund të vazhdonte tutje, në bazë të Rregullores së punës së Kuvendit, e kam ndërprerë mbledhjen me konstatimin se e njëjta do të vazhdohet pas konsultimeve apo krijimit të kushteve dhe rrethanave përkatëse, për çka do të bëhet njoftimi të gjithëve përmes e-mailit.

Si rrjedhojë e kësaj, konform rregullativës ligjore në fuqi, përmes kësaj Ftese ju njoftoj që seanca në fjalë do të vazhdoj më **29 qershor 2026, nga ora 10:00** (para seancës së rregullt) në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, dhe atë në pikën 7 të rendit të ditës, aty ku është ndërprerë.

Me respekt

Podujevë,
Datë, 16 qershor 2026

Kryesuesi i Kuvendit
Isak Shabani